



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK
Komisioni i Përhershëm për Vlerësimin e Figurave
RAPORT VENDIMMARRJE
Nr. 1 datë 16-10 2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 10 datë 07/10/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për Dhënien e titullit "Qytetar Nderi" Fahri Bukuroshi (Pas Vdekjes) i Bashkisë Pukë"

Analiza ligjore: Projekt vendimi është në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 1.7, neni 54, germa "m"; ligjit nr. 94/2022 "Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.861 datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhenien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", VKB nr.71, datë 27.12.2024 "Për miratimin e rregullores së Komisionit Këshillimor "Për titujt vendor të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre si dhe emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pukë", me propozim të kryetarit të Bashkisë Pukë, si dhe pas miratimit të Komisionit Këshillimor për Medaljet dhe Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pukë.

Situata aktuale dhe financiare e funksionit:

Anëtarët e Komisionit janë njohur nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore mbi rolin dhe kontributin e Z. Fahri Bukuroshi, Në nderim të kontributit të tij si mësues dhe drejtues shkollë për shumë vite, i cili me përkushtim e profesionalizëm formoi breza të tërë nxënësish dhe mësuesish. Një figurë frymëzuese në arsimin vendas, model i dijes dhe urtësisë, që la pas një trashëgimi të çmuar arsimore dhe qytetare.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Përhershëm për Vlerësimin e Figurave dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e vendimit.

Impakti social / grupet që preken: Projekti impakton jetën e të gjitha shtresave, kategorive të varfra në të gjithë territorin e Bashkisë Pukë

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt konsultimi me publikun

Komisioni i Përhershëm për Vlerësimin e Figurave, i mbledhur me datën 16/10/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr. 10 datë 07/10/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për Dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (Pas Vdekjes) i Bashkisë Pukë" Fahri Bukuroshi, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.


**Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,**

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
 - a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
 - b) miratimin e projektaktit

Beson Kuci 
(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Dritan H. Sani 
(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit

Datë 16.10. 2025

